	<b>PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS</b>		<b>F-009-29</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

## Përshkrimi i vendit të punës

**Data e hyrjes në fuqi: 13.02.2019**

**Pozita:**

**Zyrtar për informim - Praktikant**



**Përmbledhje**

Praktikanti është përgjegjës për të ndihmuar në koordinimin e aktiviteteve që lidhen me informimin e KEC dhe përkrahje në menaxhimin e procesit të informimit të palëve të treta për aktivitetet e KEC nëpërmjet publikimeve, web-faqes, katalogëve etj.

**Kualifikimet**


- Të jetë student i vitit të fundit në fakultet apo i sapo diplomuar në fushën e komunikimit;
- Njohuri solide të fushës së komunikimit dhe medimeve siç janë web-i dhe rrjetet sociale;
- Njohuri të mira të kuptuarit dhe shkruarit të gjuhës shqipe dhe angleze;
- Njohuri solide në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove standarde softuerike, me qëllim të organizimit të punës.

**Aftësitë tjera**

- Aftësi të mira të hulumtimit dhe përpunimit të dhënave;
- Aftësi të mira të prezantimit;
- Aftësi të mira të komunikimit;
- Aftësi për të punuar nën stres

**Detyrat**

- Përkrahje rreth organizimit të informimit të rregullt për aktivitetet e KEC;
- Dokumentimi i aktiviteteve të KEC;
- Përkrahje në mirëmbajtjen e ueb faqeve të KEC;
- Përkrahje në mirëmbajtjen e faqeve të KEC në rrjetet sociale;
- Komunikimi me media, me partnerët dhe me publikun;
- Përkrahje në përgatitjen e materialeve promovuese;
- Organizimi i përgatitjes teknike të publikimeve;

	<b>PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS</b>		<b>F-009-29</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

- Kryerja e detyrave administrative nga fushëveprimi i vet dhe e detyrave të tjera në pajtim me kualifikimin e vet.

#### **Lidhjet dhe raportimet**

Praktikanti i raporton zyrtarit për informim ose personit që e cakton drejtori ekzekutiv

#### **Orët e punës**

Praktikanti ka orar të plotë të punës prej 8 orëve në zyrën e KEC duke u nënshtruar edhe orëve shtesë varësisht prej nevojës dhe kërkesave specifike nga menaxhmenti superior.

#### **Kompensimi**

Kompensimi i Praktikantit bëhet konform kontratës së punës dhe mund të ndryshohet apo të modifikohet varësisht prej rezultateve të vlerësimit të performancës dhe vendimeve të drejtorit ekzekutiv.